



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 149

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E enjte, 18 tetor 2018**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                       | Faqe                                                                                                                                                                                                    |
|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 10913, datë 15.10.2018                                    | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9853                                                                                                                                                            |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 10914, datë 17.10.2018                                    | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9853                                                                                                                                                            |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 599, datë 9.10.2018                           | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Agjencinë<br>Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit..... 9853                                                                              |
| Vendim i Komitetit për Zhvillimin<br>e Rajoneve nr. 12, datë 16.10.2018               | Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II për vitin<br>2018, për grantin “Arsimi”..... 9854                                                                                        |
| Urdhër i ministrit të<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 667, datë 4.10.2018     | Për delegim kompetence..... 9856                                                                                                                                                                        |
| Njoftim i Ministrisë për Evropën<br>dhe Punët e Jashtme<br>nr. 15848, datë 15.10.2018 | Për hyrjen në fuqi/denoncim të marrëveshjeve..... 9856                                                                                                                                                  |
|                                                                                       | Korrigjim lidhur me udhëzimin nr. 689, datë 2.10.2018, “Për<br>nivele të kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet<br>publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”..... 9857 |

**DEKRET****Nr. 10913, datë 15.10.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Kadri Fazli Veseli

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Ilir Meta**

**DEKRET****Nr. 10914, datë 17.10.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Usni Zani Ismaili

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Ilir Meta**

**VENDIM****Nr. 599, datë 9.10.2018****PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR  
PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË  
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 95 449 680 (nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të nevojshme për zbatimin e projekteve “Ngritja dhe funksionimi i sallës operative të komandim-kontrollit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve” dhe “Përmirësimi dhe forcimi i elementeve të sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale Jordan Misja”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, të miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 12, datë 16.10.2018**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT  
PËR PROJEKTE TË REJA,  
THIRRJA II PËR VITIN 2018, PËR  
GRANTIN “ARSIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

**VENDOSI:**

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II për vitin 2018, për grantin “Arsimi”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2018, nga programet buxhetore “Arsimi bazë”, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik e të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të katërt të vitit 2018. Për projektet që nuk lidhin kontratën deri në datë 31 dhjetor 2018, shfuqizohet pika respektive në

tabelën 1 bashkëlidhur këtij vendimi, që miraton financimin e tij/tyre dhe financimi i parashikuar për atë projekt anulohet. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka të drejtë t'i rishpërndajë dhe t'i përdorë ato për një projekt tjetër (në vazhdim).

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të kryejë monitorimin e ecurisë së projekteve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe, periodikisht, Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETAR  
Senida Mesi**

|                                                 |                  |
|-------------------------------------------------|------------------|
| Zëvendëskryeministri                            | zëvendëskryetar; |
| Ministri i Financave dhe Ekonomisë              | anëtar;          |
| Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë        | anëtar;          |
| Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë          | anëtar;          |
| Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural       | anëtar;          |
| Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale   | anëtar;          |
| Ministri i Kulturës                             | anëtar;          |
| Ministri i Turizmit dhe Mjedisit                | anëtar;          |
| Ministri i Brendshëm                            | anëtar;          |
| Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë   | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore        | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë    | anëtar;          |
| Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit    | anëtar.          |

**Tabela 1.** Lista e projekteve të reja, thirrja II për vitin 2018, grantet “Arsimi” (arsimi bazë), me cikël zbatimi 2018–2019

| Nr. | Autoriteti kontraktues | Emërtimi i projektit                                                               | Vlera e plotë e projektit (në lekë) | Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018 (në lekë) | Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-të (në lekë) |                                            |                                                   |
|-----|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------|--------------------------------------------|---------------------------------------------------|
|     |                        |                                                                                    |                                     |                                                         | %                                              | Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë) | Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2018 (në lekë) |
|     |                        | <b>QARKU DIBËR</b>                                                                 |                                     |                                                         |                                                |                                            |                                                   |
| 1   | Bashkia Bulqizë        | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare në fshatin Godvi, Njësia Administrative Zerqan | 33,756,151                          | 6,076,107                                               | 10%                                            | 3,375,615                                  | 675,123                                           |



|    |                     |                                                                           |                    |                   |     |                    |                   |
|----|---------------------|---------------------------------------------------------------------------|--------------------|-------------------|-----|--------------------|-------------------|
|    |                     | <b>QARKU KUKËS</b>                                                        |                    |                   |     |                    |                   |
| 2  | Bashkia Kukës       | Rikonstruksion i shkollës së fshatit Fshat                                | 22,137,136         | 3,099,199         | 30% | 6,641,141          | 1,328,228         |
| 3  | Bashkia Has         | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, Tregtan, Njësia Administrative Fajzë | 24,552,135         | 4,419,384         | 10% | 2,455,214          | 491,043           |
|    |                     | <b>QARKU ELBASAN</b>                                                      |                    |                   |     |                    |                   |
| 4  | Bashkia Belsh       | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, fshati Seferan                       | 20,000,000         | 3,600,000         | 10% | 2,000,000          | 400,000           |
|    |                     | <b>QARKU DURRËS</b>                                                       |                    |                   |     |                    |                   |
| 5  | Bashkia Durrës      | Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Jusuf Puka”                                | 140,000,000        | 14,000,000        | 30% | 42,000,000         | 14,000,000        |
|    |                     | <b>QARKU FIER</b>                                                         |                    |                   |     |                    |                   |
| 6  | Bashkia Roskovec    | Rikonstruksioni i shkollës Velmish                                        | 57,411,148         | 10,334,007        | 10% | 5,741,115          | 1,148,223         |
| 7  | Bashkia Fier        | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Anastas Laska”, rrethi i Libofshës   | 45,907,249         | 6,427,015         | 30% | 13,772,175         | 2,754,435         |
| 8  | Bashkia Lushnjë     | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Karbunare e Vogël”                   | 60,990,241         | 8,538,634         | 30% | 18,297,072         | 3,659,414         |
| 9  | Bashkia Mallakastër | Rikonstruksion i shkollës, Hekal                                          | 33,769,658         | 6,078,538         | 10% | 3,376,966          | 675,393           |
|    |                     | <b>QARKU KORÇË</b>                                                        |                    |                   |     |                    |                   |
| 10 | Bashkia Korçë       | Rindërtim shkollës 9-vjeçare, Voskopojë                                   | 50,365,000         | 7,051,100         | 30% | 15,109,500         | 3,021,900         |
| 11 | Bashkia Pogradec    | Rehabilitim i shkollës 9-vjeçare “Sami Zgiani”, Gurras                    | 21,876,499         | 3,062,710         | 30% | 6,562,950          | 1,312,590         |
| 12 | Bashkia Devoll      | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Dritëro Agolli”, Bilisht             | 84,701,381         | 15,246,249        | 10% | 8,470,138          | 1,694,028         |
|    |                     | <b>QARKU SHKODËR</b>                                                      |                    |                   |     |                    |                   |
| 13 | Bashkia Fushë-Arrëz | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, Fierzë                               | 32,350,000         | 5,823,000         | 10% | 3,235,000          | 647,000           |
|    |                     | <b>QARKU TIRANË</b>                                                       |                    |                   |     |                    |                   |
| 14 | Bashkia Kamzë       | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nënë Tereza”, Laknas                 | 43,314,754         | 6,064,066         | 30% | 12,994,426         | 2,598,885         |
|    | <b>TOTALI</b>       |                                                                           | <b>671,131,352</b> | <b>99,820,008</b> |     | <b>144,031,311</b> | <b>34,406,262</b> |

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën e plotë të zbatimit të punimeve, sipas vlerësimeve të projektit (paraqitur nga aplikuesi sipas fazës/projektit që financohet). Diferenca midis vlerës së plotë të projektit me vlerën e kontratës (nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik dhe mbas nënshkrimit të saj), do t’i zbritet financimit nga FZHR-ja (në vitin 2019), me burim grantet “Arsim”, pjesë e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. “Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018” është financimi që jepet për vitin 2018, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Arsimi bazë”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2018.

3. “Përqindja dhe vlera e plotë e bashkëfinancimit nga NJQV-të” është sipas pikës 4, të vendimit nr. 11, datë 27.9.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe numrit të popullsisë së bashkisë.

4. “Vlera e financimit nga NJQV-të për vitin 2018 dhe 2019” përfaqëson kontributin financiar të bashkisë, në “vlerën e plotë të projektit”, si bashkëfinancim i projektit që merret përsipër të paguhet nga buxheti i vetë aplikuesit/autoritetit kontraktor, respektivisht në vitin 2018 dhe 2019.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në rolin e sekretariatit teknik të granteve “Arsimi”, bën verifikimin e disponueshmërisë së “vlerës së financimit nga NJQV-të për vitin 2018 dhe 2019”, për financimin e projektit, si dhe parashikimin e kësaj vlere nga bashkia, përpara çeljes së fondit që financohet nga FZHR-ja, në favor të autoritetit kontraktues.

6. Likuidimi financiar për financimin nga FZHR-ja të vlerës së projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite (2018–2019).

**URDHËR****Nr. 667, datë 4.10.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 5, të ligjit nr. 8038, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për nënshkrimin e:

- Licencave dhe të certifikatave të operimit, për transportin ndërqytetës të udhëtarëve;
- Certifikata për transport ndërkombëtar dhe të brendshëm të rastit.

2. Delegimin e kompetencës DPSHTRR-së për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve për miratimin e licencave nëpërmjet QKB-së, në veprimtarinë e nënkategorisë VII.7.1, “Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve”.

3. Në ushtrimin e kësaj kompetence, DPSHTRR-ja të zbatojë kriteret e përcaktuara, në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar.

Faqe | 9856

4. Ngarkohet DPSHTRR-ja për zbatimin e këtij urdhri dhe koordinimin me QKB-në për zbatimin e procesit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjijnuri**

**NJOFTIM****Nr. 15848, datë 15.10.2018****PËR HYRJEN NË FUQI/DENONCIM TË  
MARRËVESHJEVE**

1. Marrëveshja me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënshkruar në Tiranë, më 19 prill 2018, ka hyrë në fuqi më 16.8.2018.

2. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, nënshkruar më 6.7.2015, është denoncuar më 3.10.2018.

3. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”, nënshkruar më 6.7.2015, është denoncuar më 3.10.2018.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I  
MINISTRIË PËR EVROPËN DHE  
PUNËT E JASHTME  
**Gazmend Barbullushi**



**KORRIGJIM LIDHUR  
ME UDHËZIMIN NR. 689, DATË  
2.10.2018, “PËR NIVELIN E KUOTAVE  
TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE  
REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË  
PËRKUJDESJES SHOQËRORE”**

Në Fletoren Zyrtare nr. 145, datë 10.10.2018, është botuar udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Korrigjimi konsiston në tabelat bashkëlidhur këtij udhëzimi, të cilat kanë karakter informues dhe nuk janë pjesë përbërëse e tij.

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë